



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.9/2026

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Srpska Lista, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.06.2026, merr këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa e Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZP.Anr.9/2026, e datës 30.05.2026, parashtruar kundër subjektit Politik Srpska Lista, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 07 Qershor 2026.

#### A r s y e t i m

Me datë 30.05.2026 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit politik "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" duke ndjekur rrjetet sociale në lidhje me fushatën politike, kanë vërejtur se në platformën Facebook, zyrtari i lartë politik i Listës Serbe, Igor Simiq, gjatë një tubimi të mbajtur në Zveçan, ka bërë deklaratat publike të drejtuara kundër përfaqësuesit politik të "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", Nenad Rashiq, duke përdorur pretendime që përbëjnë akuza serioze pa paraqitur fakte apo prova të disponueshme publike, ku sipas nenit 34 paragrafi 1

pika 11 të Ligjit nr. 08/L-228, duhet pasur parasysh se përmbajtja e fushatës duhet të jetë në përputhje me parimet e konkurrencës demokratike, respektimit të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor dhe zhvillimit të një fushate të përgjegjshme. Tutje kanë shtuar se “Kjo është politika e Nenad Rashiqit i cili ngriti gishtin kundër serbëve të ndershëm në Graçanicë, kundër Bratislavit, kundër Mirjanës, kundër Ljubishës dhe kundër të tjerëve që u arrestuan dhe u mbajtën në paraburgim për 30 ditë pa faj...” “Kjo është politika që ai ua premtoi juve, o populli im i mirë, kur fliste për integrimin pa dhimbje të shëndetësisë dhe arsimit, të cilin ne në Listën Serbe e shohim si një përqaftim të vdekjes...” Ankuesi konsideron se deklaratat në fjalë tejkalojnë kufijtë e kritikës së lejuar politike dhe përbëjnë parashtrim publik të pretendimeve të pabazuara, me të cilat kundërshtari politik lidhet drejtpërdrejt me arrestimet e disa personave, pa ofruar prova apo fakte që do të vërtetonin pretendime të tilla. Tutje kanë theksuar se veprimi i tillë mund të mashtrtojë votuesit, të dëmtojë barazinë e konkurrencës politike dhe të ndikojë negativisht në integritetin e procesit zgjedhor. Kanë kërkuar nga PZAP që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të merre vendim me të cilën do ta dënoj subjektin politik Srpska Lista në përputhje me normat ligjore dhe rregullat që lidhen me fushatën zgjedhore.

Si dëshmi për pretendimet e tij, parashtruesi i ankesës, ka bashkangjitur një CD me pamje dhe audio e cila dëshmon të lartcekurat në këtë ankesë.

Në përgjigje në ankesë paraqitur më datë 31.05.2026, nga subjekti politik Srpska Lista kanë theksuar se në lidhje me ankesën e paraqitur pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, ZP.Anr.9-2026, më datë 30.5.2026, me të cilën subjekti ynë politik akuzohet se ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenin 34, paragrafi 1, pika 11, sepse sipas tyre anëtari ynë ka bërë akuza të rënda kundër z. Nenad Rašić, dëshirojmë t'i hedhim poshtë absolutisht dhe me përgjegjësi të plotë këto pretendime. Pas shqyrtimit të fjalimit të anëtarit tonë, z. Simić, tekstin e të cilit pjesërisht e ka dhënë edhe vetë ankuesi, si kundërshtar politik, z. Simić ka kritikuar politikën e z. Rašić dhe ka dhënë vlerësim politik të politikës së tij, e jo të tij personalisht. Në atë rast, ai nuk ka shkelur në asnjë moment ligjin dhe rregullat zgjedhore, as nuk ka nxitur urrejtje apo dhunë, siç pretendon ankuesi duke u thirrur në nenin 34, paragrafi 1, pika 11: “1.11. përdorimi i gjuhës, me shkrim ose me gojë, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë një person tjetër të kryejë një akt dhune ndaj personave tjerë ose pasurisë, ose me të cilën nxit ose mund të nxisë urrejtje ndaj të tjerëve, ose publikimi ose përdorimi i fotografive, simboleve ose çdo lloj materiali tjetër që mund të ketë një ndikim të tillë.” Tutje kanë theksuar se në fjalimin e tij në kuadër të fushatës zgjedhore, në përputhje me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme 08/L-228 dhe Kushtetutën e Kosovës ka

ushtruar të drejtën e lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 40 të Kushtetutës së Kosovës dhe ka dhënë vlerësim të politikës që mbron z. Rašić, të cilën subjekti ynë politik e kritikon, dhe në atë rast ka thënë: “Zgjedhjet janë të vështira, por zgjedhja nuk ka qenë kurrë më e lehtë. Në 13 vjet marrje me politikë, nuk kam akuzuar kurrë askënd me emër, por dua të akuzoj politikën që po e çon popullin tonë drejt zhdukjes. Ajo është politika e Nenad Rašić”. Tutje kanë theksuar “Lista Serbe nuk po lufton kundër Nenad Rašić, por kundër politikës së tij, e cila, siç tha ai, po çon drejt zhdukjes”. Kritika e politikës së mbështetur nga një përfaqësues politik është aktivitet normal politik i të gjitha subjekteve politike, përfshirë edhe z. Simić. Në fjalimin e tij nuk ka pasur asnjë fjalë për personalitetin e Nenad Rašić, as ndonjë thirrje për dhunë, apo ndonjë gjë që nxit dhunën. Për ta bërë absurdin edhe më të madh, vetë ankuesi në ankesën e tij, të cilën e bashkëlidhim në materiale, ka përmendur një citat të shkurtuar të fjalimit të z. Simić, i cili edhe ashtu i shkurtuar është i qartë, sepse thekson se bëhet fjalë për politikën e z. Rašić, e jo për të personalisht. Kanë kërkuar nga PZAP që ta refuzoj ankesën si të pabazuar.

Si dëshmi i kanë bashkangjitur linçet e fjalimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”. Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Srpska Lista, Paneli i vlerësoj në aspektin e lirisë së shprehjes dhe formës së shprehje dhe konkludoi se jo çdo akuze politike gjatë fushatës zgjedhore mund të konsiderohet gjuhë urrejtëse.

Veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkeljet e pretenduara dhe se fjalimi i mbajtur në tubimin e lartcekur nuk mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Sjelljes për Subjektet

Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët dhe parimit të barazisë dhe integritetit të garës nga se deklaratimet e tilla konsiderohen diskurs politik i zakonshëm, e qe në fushatë zgjedhore kufijtë e kritikës politike mund të jenë më të gjerë dhe se shikuar nga konteksti i fjalimit, deklaratimet e tij paraqiten si vlerësime politike e jo si gjuhë që mund të nxis akte të dhunës apo të nxis urrejtje.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankese dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.9/2026, datë 01.06.2026

Kryesues i Panelit  
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.